



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM  
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU  
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



ZRRUK

# RAPORT VJETOR

PËR AKTIVITETET E

## KOMISIONEVE KËSHILLUESE TË KONSUMATORËVE

PËR PERIUDHËN: JANAR – DHJETOR  
2012

Përgatitur nga:

**Sylë Sylja**

Analist i Shërbimeve të  
Konsumatorëve dhe zyrtar për Ligj dhe  
Licenca

Departamenti për Ligj dhe Licenca

# Përmbajtja

---

1.	Hyrje	3
2.	Roli dhe përgjegjësitë e ZRRUK	3
3.	Përbërja e KKK-ve	4
3.1	KKK i Regjionit të Prishtinës	4
3.2	KKK i Regjionit të Mitrovicës	4
3.3	KKK i Regjionit të Ferizajit	5
3.4	KKK i Regjionit të Gjilanit	5
3.5	KKK i Regjionit të Prizrenit	5
3.6	KKK i Regjionit të Pejës	6
3.7	KKK i Regjionit të Gjakovës	6
4.	Aktivitetet e ZRRUK lidhur me KKK-të në 2012	7
4.1.	Bashkëpunimi me institucionet relevante	7
4.2.	Vendosja e Kutive për Ankesat e Konsumatorëve	7
4.3.	Vizita Studimore në Angli	7
4.4.	Organizimi i Punëtorive ('Workshopeve')	8
4.5.	Implementimi i Hulumtimit të Opinionit të Konsumatorëve (Sondazhit)	8
4.6.	Informimi i Konsumatorëve për Rolin dhe Funkcionet e KKK-ve	9
5.	Aktivitetet e KKK-ve në Shqyrtimin e Ankesave	9
5.1.	Numri i Ankesave të Parashtruara KKK	10
5.2.	Numri i Ankesave të zgjedhura nga KKK	10
5.3.	Natyra e Ankesave të Parashtruara	11
5.4.	Shpërndarja Gjeografike e Ankesave të Parashtruara	11
5.5.	Kategoria e Konsumatorëve - Konsumatorët Shtëpiak	12
5.6.	Kategoria e Konsumatorëve - Konsumatorët Jo-shtëpiak	12
6.	Lista e anëtarëve të komisioneve këshilluese të konsumatorëve	13

## 1. Hyrje

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Kanalizim (ZRRUK) është Rregullator i pavarur ekonomik përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të kompanive publike që ofrojnë Shërbimet e Ujësjellësit, Kanalizimit në Kosovë. ZRRUK është themeluar me 26 Nëntor 2004 me **Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49** në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës .Rregullorja 2004/49 është amendamentuar me **Ligji Nr. 03/L-086** të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me datë 13 Qershor 2008 duke transferuar kështu përgjegjësitë për rregullimin e sektorit të ujit dhe kanalizimit nga UNMIK –u tek Kuvendi i Kosovës .

Duhet potencuar , se me aprovimin e Ligjit për Mbeturina Nr: 04/L-60, Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina nga data 16.07.2012 nuk është kompetente për rregullimin e sektorit të mbeturinave në Kosovë. Emri i Rregullatorit, deri në amendamentimin e Ligjit Nr .03/L-086 do të jetë Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK).

## 2. Roli dhe përgjegjësitë e ZRRUK

Përgjegjësitë kryesore të ZRRUK janë:

- Lëshimi i Licencave për Ofruesit e Shërbimeve për ujë dhe kanalizim ,
- Përcaktimi i Tarifave që balancojnë nevojat e konsumatorëve për çmime të përballueshme dhe ruajtjen e integritetit financiar të Ofruesve të Shërbimeve,
- Monitorimi dhe raportimi i performancës së Ofruesve të Shërbimeve,
- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve duke siguruar që Ofruesit e Shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e monopolit dhe duke siguruar që shërbimet ofrohen në pajtim me standardet adekuate dhe të përcaktuara të shërbimeve
- Themelimi dhe përkrahja e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve

Një ndër funksionet dhe përgjegjësitë më të rëndësishme të ZRRUK është edhe mbrojtja e qëndrueshme e interesave të konsumatorëve duke u përkujdesur, që shërbimet që atyre iu ofrohen nga Kompanitë e licencuara janë në nivelin e standardeve të përcaktuara, dhe se ata kanë në dispozicion mekanizma efektiv për adresimin e ankesave dhe pakënaqësive të tyre. Me qëllim të realizimit të këtyre interesave, konform Nenit 7 pika 7.1 të Rregullit për Komisionin Këshillues të Konsumatorëve për Shërbimet e Ujit dhe Mbeturinave në Kosovë (ZRRUM-R-08/ W & S W ) nga data 05.04. 2011, është paraparë Themelimi i Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK) si dhe janë përcaktuar modalitetet dhe funksionimi i këtyre Komisioneve. Andaj, në harmoni me këto dispozita, ZRRUK në muajin Qershor të vitit

2011 pas shqyrtimit të propozimeve nga Kuvendet Komunale, intervistave të bëra dhe konsultimeve ka bërë themelimin e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në 7 Regjione të Kosovës sipas Planit për Konsolidimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe Mbeturinave.

Secila komunë brenda Regjionit të përcaktuar i ka 1 (një) përfaqësues respektiv në KKK

Në këtë Raport është dhënë në formë të përmbledhur një pasqyrë të aktiviteteve të KKK gjatë vitit 2012.

### **3. Përbërja e KKK-ve**

#### **3.1 KKK i Regjionit të Prishtinës**

Në KKK të Regjionit të Prishtinës janë të përfaqësuara me nga 1 (një) përfaqësues komunat vijuese:

- (i) Kuvendi Komunal Prishtinë
- (ii) Kuvendi Komunal Fushë Kosovë
- (iii) Kuvendi Komunal Obiliq
- (iv) Kuvendi Komunal Podujevë
- (v) Kuvendi Komunal Lipjan
- (vi) Kuvendi Komunal Gllogoc
- (vii) Kuvendi Komunal Shtime
- (viii) Kuvendi Komunal Graçanicë

#### **3.2 KKK i Regjionit të Mitrovicës**

Në KKK të Regjionit të Mitrovicës janë të përfaqësuara me nga 1 (një) përfaqësues komunat vijuese:

- (i) Kuvendi Komunal Mitrovicë
- (ii) Kuvendi Komunal Vushtrri
- (iii) Kuvendi Komunal Skenderaj

### **3.3 KKK i Regjionit të Ferizajit**

Në KKK të Regjionit të Ferizajit janë të përfaqësuara me nga 1 (një) përfaqësues komunitat vijuese:

- (i) Kuvendi Komunal Ferizaj
- (ii) Kuvendi Komunal Kaçanik
- (iii) Kuvendi Komunal Elez Han
- (iv) Kuvendi Komunal Shtërpce

### **3.4 KKK i Regjionit të Gjilanit**

Në KKK të Regjionit të Gjilanit janë të përfaqësuara me nga 1 (një) përfaqësues komunitat vijuese:

- (i) Kuvendi Komunal Gjilan
- (ii) Kuvendi Komunal Viti
- (iii) Kuvendi Komunal Kamenicë
- (iv) Kuvendi Komunal Novobërdë
- (v) Kuvendi Komunal Partesh
- (vi) Kuvendi Komunal Klllokot
- (vii) Kuvendi Komunal Ranillug

### **3.5 KKK i Regjionit të Prizrenit**

Në KKK të Regjionit të Prizrenit janë të përfaqësuara me nga 1 (një) përfaqësues komunitat vijuese:

- (i) Kuvendi Komunal Prizren
- (ii) Kuvendi Komunal Suharekë
- (iii) Kuvendi Komunal Dragash
- (iv) Kuvendi Komunal Mamushë
- (v) Kuvendi Komunal Malishevë

### **3.6 KKK i Regjionit të Pejës**

Në KKK të Regjionit të Pejës janë të përfaqësuara me nga 1 (një) përfaqësues komunat vijuese:

- (i) Kuvendi Komunal Pejë
- (ii) Kuvendi Komunal Istog
- (iii) Kuvendi Komunal Deçan
- (iv) Kuvendi Komunal Klinë
- (v) Kuvendi Komunal Junik

### **3.7 KKK i Regjionit të Gjakovës**

Në KKK të Regjionit të Gjakovës janë të përfaqësuara me nga 1 (një) përfaqësues komunat vijuese:

- 2. Kuvendi Komunal Gjakovë
- 2. Kuvendi Komunal Rahovec

Gjatë periudhës Raportuese janë mbajtur **70** takime të rregullta të KKK, ku janë shqyrtuar 226 çështje të rëndësishme për konsumatorë sikurse janë :

- Shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve,
- Aprovimi i Procesverbaleve,
- Njoftimi me Propozimin e Tarifave për grumbullimin e mbeturinave për periudhën 1.06.2012-31.05.2013,
- Shqyrtimi i situatës lidhur me furnizimin me ujë të konsumatorëve,
- Informacion lidhur me zbatimin e Rregullës për Standardet minimale të Shërbimit,
- Informacion lidhur me zbatimin e Rregullës për Kartën e Konsumatorëve ,
- Shqyrtimi i Draft Propozimit të Rregullës për përcaktimin e Tarifave të ujit ,

- Informacion lidhur me procesin e Licencimit të Kompanive të ujit

Si dhe shqyrtimi i çështjeve tjera të cilat janë në interes të konsumatorëve .

## **4. Aktivitetet e ZRRUK lidhur me KKK-të në 2012**

### **4.1. Bashkëpunimi me institucionet relevante**

Në vitin 2012 ZRRUK ka vazhduar të bashkëpunoi ngushtë dhe të konsultohet me kompanitë e ujësjellësit si dhe me palët tjera të interesit me çështjet të cilat kanë të bëjnë me punën e KKK, lidhur me mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Në këtë drejtim është zhvilluar një bashkëpunim i ngushtë me OJÇ “Konsumatori” , Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Institutin IPA si dhe me Entin Rregullator të Ujit të Shqipërisë (ERRU) lidhur me shkëmbimin e përvojave, dhe përsosjes së bashkëpunimit në këtë drejtim.

### **4.2. Vendosja e Kutive për Ankesat e Konsumatorëve**

ZRRUK gjegjësisht KKK edhe kësaj here kanë kërkuar nga Kompanitë e licencuara të ujësjellësit që të bëhet vendosja e kutive për ankesa në vend të dukshëm në objektet e tyre, ku konsumatorët e pakënaqur me përgjigjen e marrë nga kompania, mundën të drejtojnë ankesat KKK-të për Regjionin përkatës.

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit në këtë drejtim, në marrëveshje me Ofruesit e Shërbimeve të ujit është vendosur që çelësat e kutive të hapen kryesisht të KKK, të cilët para çdo takimi i tërheqin ankesat e vendosura në kuti.

### **4.3. Vizita Studimore në Angli**

Në mbështetjen e mëtutjeshme institucionale të ZRRUK nga ana e Zyrës ndërlidhëse të Komisionit Evropian (ZNKE) , Instituti IPA nga data 01-04 prill 2012 për Kryesuesit e KKK dhe disa zyrtarëve të stafit të ZRRUK, ka organizuar një vizitë studimore në Angli. Fokus i interesimit në këtë vizitë studimore ka qenë njohja me rolin dhe mënyrën e funksionimit të KKK ,raportet me OFWAT nga Birmingham si Rregullator i kompanive të ujit dhe ujërave të zeza .Njoftimi me përvojat, dhe praktikat e tyre lidhur me procedurat për parashtrimin, trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, si dhe përfaqësimin e interesave të konsumatorëve .


#### 4.4. Organizimi i Punëtorive ('Workshopeve')

Me qëllim të avancimit dhe njohjes me ecuritë bashkëkohore lidhur me komunikimin me konsumator dhe zgjidhjen e ankesave , ZRRUK në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Industrisë si dhe me OJQ relevante në muajin maj ka organizuar punëtori-workshop me temë "**Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve**". Po ashtu në vazhden e bashkëpunimit me ftesën e Entin Rregullativ të Ujit nga Shqipëria në muajin qershor është mbajtur punëtorja me temën "**Kodi i Punës së ZRRUK**". Kryesuesi i KKK nga Regjioni i Prizrenit në muajin nëntor 2012 në Shqipëri ka patur prezantim me temë "**Kostot operative të ujit nga aspekti i KKK në Kosovë**"


#### 4.5. Implementimi i Hulumtimin të Opinionit të Konsumatorëve (Sondazhit)

Për të krijuar një pasqyre sa ma reale lidhur me nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit, ZRRUK gjatë muajit Tetor-Nëntor ka realizuar projektin "**Hulumtimin e opinionit të konsumatorëve për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit në Kosovë**". Ky hulumtim është me rëndësi të veçantë për ZRRUK , sepse përmes të këtyre të dhënave që dalin nga ky hulumtim,nxirët një pasqyrë e qartë lidhur me opinionet e konsumatorëve ndaj shërbimeve të ofruesve të shërbimeve të ujit dhe kanalizimit që Licencohen dhe monitorohen nga ZRRUK .

#### A keni njohuri për KKK-në (Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve)?



### Sa jeni të kënaqur me shërbimet e ujësjellësit?



Me këtë projekt janë anketuar 1542 respondentë –konsumatorë në tërë territorin e Kosovës .Përpilim i Raportit nga ky hulumtim do ti shërbejë ZRRUK si pikë referimi për gjendjen aktuale, dhe planifikimin e veprimeve të ardhshme për ngritjen e cilësisë së shërbimeve të konsumatorëve në Kosovë.

#### 4.6. Informimi i Konsumatorëve për Rolin dhe Funksonet e KKK-ve

Me qëllim të informimit të konsumatorëve dhe sensibilizimin e opinionit publik për rolin e KKK-ve, ZRRUK është angazhuar aktivisht në bashkëpunim me KKK-të regjionale që të promovohet roli i tyre përmes mjeteve të informimit . Me qëllim të krijimit të kushteve për participim aktiv të konsumatorëve në çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit , ZRRUK përmes gazetave ditore ka bërë publik Orarin e takimeve mujore të KKK . Po ashtu gjatë muajit Nëntor-Dhjetor 2012 në RTK është transmetua kampanja lidhur me rolin e ZRRUK dhe KKK . ZRRUK përmes ueb.faqes [www.wwro-ks.org](http://www.wwro-ks.org) iu ka mundësuar konsumatorëve që të informohen detalisht lidhur me aktivitetet të cilat po i zhvillon ZRRUK . Gjithashtu ZRRUK ka përgatitur dhe shpërndarë broshura lidhur me Standardet minimale të Shërbimeve të ujit dhe kanalizimit . Në këtë drejtim janë duke u bërë përpjekje të mëtejshme me qëllim të informimit sa ma të mirë të konsumatorëve.

#### 5. Aktivitetet e KKK-ve në Shqyrtimin e Ankesave

Në vijim është dhënë në formë tabelore, numri dhe struktura e ankesave të parashtruara dhe të shqyrtuara nga KKK-të regjionale në vitin 2012.

## 5.1. Numri i Ankesave të Parashtruara KKK

REGJIONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsejt
KKK Prishtinë	9	4	6	2	-	6	-	5	2	2	6	11	53
KKK Mitrovicë	-	-	-	1	-	1	-	-	-	-	-	-	2
KKK Pejë	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1
KKK Gjakovë	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Prizren	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Ferizaj	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Gjilan	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1
<b>Gjithsejtë</b>	<b>10</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>7</b>	<b>-</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>11</b>	<b>60</b>

## 5.2. Numri i Ankesave të zgjedhura nga KKK

REGJIONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsejt
KKK Prishtinë	-	1	-	-	2	-	-	2	-	-	8	9	22
KKK Mitrovicë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KKK Pejë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KKK Gjakovë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KKK Prizren	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	1
KKK Ferizaj	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Gjilan	-	-	1	-	-	-	-	-	-	1	-	-	2
<b>Gjithsejtë</b>	<b>-</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>-</b>	<b>2</b>	<b>-</b>	<b>1</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>26</b>

**Shënim:**

**11 - Ankesa iu janë dërguar Kompanive në RISHQYRTIM**

**7 - Ankesa iu janë kthyer palëve për plotësim lënde.**

**16 - Ankesa në bashkëveprim me Kompanitë dhe konsumatorët janë zgjedhur.**

### 5.3. Natyra e Ankesave të Parashtruara

REGJIONI	Zbritja/Shlyerja e Borxhit	Faturimi Paushall	Tarifat e Larta	Gjithsejt
KKK Prishtinë	31	20	2	53
KKK Mitrovicë	2	--	-	2
KKK Pejë	-	1	-	1
KKK Gjakovë	-	1	-	1
KKK Prizren	1	-	-	1
KKK Ferizaj	1	-	-	1
KKK Gjilan	-	1	-	1
<b>Gjithsejtë</b>	<b>35</b>	<b>23</b>	<b>2</b>	<b>60</b>

### 5.4. Shpërndarja Gjeografike e Ankesave të Parashtruara

REGJIONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsejt
KKK Prishtinë	9	4	6	2	-	6	-	5	2	2	6	11	53
KKK Mitrovicë	-	-	-	1	-	1	-	-	-	-	-	-	2
KKK Pejë	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1
KKK Gjakovë	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Prizren	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Ferizaj	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Gjilan	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1
<b>Gjithsejtë</b>	<b>10</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>7</b>	<b>-</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>11</b>	<b>60</b>

### 5.5. Kategoria e Konsumatorëve - Konsumatorët Shtëpiak

REGJIONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsejt
KKK Prishtinë	9	2	4	3	-	6	-	3	2	2	6	11	48
KKK Mitrovicë	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	1
KKK Pejë	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1
KKK Gjakovë	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Prizren	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Ferizaj	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Gjilan	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1
<b>Gjithsejtë</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>7</b>	<b>-</b>	<b>5</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>11</b>	<b>54</b>

### 5.6. Kategoria e Konsumatorëve - Konsumatorët Jo-shtëpiak

REGJIONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsejt
KKK Prishtinë	-	1	1	-	-	-	-	2	1	-	-	-	5
KKK Mitrovicë	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Pejë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KKK Gjakovë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KKK Prizren	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KKK Ferizaj	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KKK Gjilan	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Gjithsejtë</b>	<b>-</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>6</b>

## 6. Lista e anëtarëve të komisioneve këshilluese të konsumatorëve

KKK	Emri	Pozita	Kuvendi Komunal	Nr. kontaktues
KKK PRISHTINA	Teuta Rugova	Kryetare	Prishtinë	044/158 989
	Kadri Shalaku	Anëtar	Obiliq	044/556 688
	Jasmine Hysaj	Anëtar	Shtime	044/044 193
	Hamdi Qerimi	Anëtar	Fushë Kosovë	044/299 025
	Arsim Ajvazi	Anëtar	Podujevë	044/123 529
	Sasha Zdravković	Anëtar	Graçanicë	049/776 585
	Burim Kastrati	Anëtar	Drenas	044/552 890
	Xhelal Limani	Anëtar	Lipjan	044/932 626
KKK Prizreni	Fejsal Hoti	Kryetar	Prizren	044/268 597
	Berat Berisha	Anëtar	Suharekë	044/218 230
	Hamzi Hujaj	Anëtar	Dragash	044/201 039
	Fikret Morina	Anëtar	Mamushë	045/270 744
	Hasan Mazreku	Anëtar	Malishevë	044/890 311
KKK Pejë	Drita Kelmendi-Kukaj	Kryetare	Pejë	044/298 803
	Muhamet Raxhaj	Anëtar	Istog	044/138 634
	Zenel Kuqi	Anëtar	Junik	044/134 051
	Sadri Lokaj	Anëtar	Deçan	044/134 123
	Liridon Hoxhaj	Anëtar	Klinë	044/231 165
KKK Mitrovicë	Fatime Krasniqi	Kryetare	Mitrovicë	044/773 832
	Agron Lushtaku	Anëtar	Skenderaj	044/192 393
	Sevdije Sadiku	Anëtar	Vushtri	044/732 053
KKK Gjakovë	Musë Gjergjaj	Kryetar	Gjakovë	044/307 890
	Florian Hasku	Anëtar	Rahovec	044/200 691
KKK Ferizaj	Zekri Bytyçi	Kryetar	Ferizaj	044/756 233
	Zymer Bushi	Anëtar	Hani i Elezit	044/224 904
	Afrim Bajrami	Anëtar	Kaçanik	044/183 563
KKK Gjilan	Burbuqe Zymberi	Kryetare	Gjilanë	044/370 040
	Haxhi Qerimi	Anëtar	Viti	044/209 908
	Mirvete Rashiti	Anëtar	Kamenicë	044/368 749
	Ivica Radiq	Anëtar	Klllokot	044/357 724
	Dragan Aleksiq	Anëtar	Ranillug	045/482 146
	Sami Vllasaliu	Anëtar	Novoberdë	044/293 279
	Dejan Jociq	Anëtar	Partesh	044/376 788